BUXHETI QYTETAR I KOMUNËS SË STRUGËS
PËR VITIN 2026



Strugë, 2026

Të nderuar qytetarë,

Buxheti i Komunës së Strugës për vitin 2026 përfaqëson një nga dokumentet më të rëndësishme strategjike përmes të cilit e definojmë drejtimin e zhvillimit të komunës sonë dhe mënyrën se si i menaxhojmë me përgjegjësi mjetet publike. Buxheti është shprehje e vizionit tonë të përbashkët për një vetëqeverisje lokale funksionale, bashkëkohore dhe sociale të përgjegjshme, e orientuar drejt një cilësie më të mirë të jetës për të gjithë qytetarët.

Ky buxhet është miratuar nga Këshilli i Komunës së Strugës në seancën e mbajtur më 31 dhjetor 2025, pas një procesi planifikimi të bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies, efikasitetit dhe ligjshmërisë. Gjatë përgatitjes së tij janë marrë parasysh nevojat reale të bashkësisë lokale, propozimet dhe iniciativat tuaja, si dhe mundësitë dhe kufizimet financiare të përcaktuara me kornizën ligjore në fuqi.

Buxheti për vitin 2026 është konceptuar si një plan financiar i balancuar që siguron stabilitet, vazhdimësi dhe zhvillim. Theks i veçantë u është vënë investimeve kapitale dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike, me qëllim përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve. Mjetet e planifikuara janë orientuar drejt zhvillimit të infrastrukturës, përmirësimit të arsimit, kulturës dhe sportit, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe pastërtisë publike, forcimit të mbrojtjes sociale si dhe mbështetjes së zhvillimit ekonomik lokal.

Jemi të vetëdijshëm se përballemi me sfida të shumta - ekonomike, sociale dhe institucionale. Prandaj, ky buxhet nuk është vetëm një përmbledhje e të hyrave dhe shpenzimeve, por një instrument për menaxhim të përgjegjshëm për marrjen e vendimeve të menduara dhe për krijimin e zgjidhjeve afatgjate në interes të qytetarëve. Qëllimi ynë është që çdo denarë të shfrytëzohet në mënyrë racionale, transparente dhe në dobi të qytetarëve.

Besojmë se përmes bashkëpunimit institucional, debatit publik konstruktiv dhe përgjegjësisë së përbashkët, Buxheti për vitin 2026 do të jetë bazë për zhvillim të qëndrueshëm dhe përparim të Komunës së Strugës. Vetëqeverisja lokale mbetet e hapur për dialog, partneritet dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve në krijimin e politikave që e ndërtojnë komunitetin tonë.

Me respekt,
Mendi Qyra
Kryetar i Komunës së Strugës

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TRANSPARENCA BUXHETORE?

Transparenca në buxhetimin komunal është e një rëndësie të veçantë për stabilitetin financiar, zhvillimin ekonomik dhe demokracinë (obliguesit tatimor, qytetarët dhe shoqërinë në përgjithësi). Transparenca dhe shpërndarja e informacioneve është kyçe për pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme sociale në miratimin e vendimeve/procesin e buxhetimit. Në qoftë se opinioni publik ka besim në shpenzimin e financave publike, qytetarët do të jenë më të motivuar që ti pagojnë tatimet dhe taksat komunale, gjë që do të reflektoj pozitivisht në buxhetin e vetëqeverisjes lokale. Rritja e transparencës çon deri në uljen e korrupsionit dhe shpërndarje më të mirë të resurseve. Transparenca në nivel lokal e ndjek ecurinë e financave nga burimi i tyre deri te shpenzimi i tyre.

ÇFARË ËSHTË BUXHETI I KOMUNËS DHE BUXHETI QYTETAR I KOMUNËS?

Buxheti është një nga politikat më të rëndësishme të pushtetit lokal. Nëpërmjet buxhetit ndahen mjetet financiare të komunave që janë të nevojshme për realizimin e të drejtave të të gjithë qytetarëve në komunë. Përdoret për të planifikuar se si një qeverisje lokale do të mbledhë dhe shpërndajë financat publike për të përmbushur politikat dhe objektivat e saj.

BUXHETI I KOMUNËS përfaqëson një plan vjetor të të gjithë të hyrave, hyrjeve dhe fondeve të miratuara dhe të gjitha shpenzimeve dhe fondeve të dalura, si dhe përfshin buxhetin bazë të komunës, buxhetin e dotacioneve, buxhetin e donacioneve, buxhetin e kredive dhe buxhetin e aktiviteteve vetëfinancuese.

TË HYRAT

-Të hyrat tatimore
-Të hyrat jotatimore
-Të hyrat kapitale
-Transfere dhe donacione
-Borxhi në vend
-Huamarrje jashtë vendit

SHPENZIMET

- Rrogat dhe kompenzimet
-Rezervat dhe shpenzimet e padefinuara
-Mallrat dhe shërbimet
- Interesi
- Subvencione dhe transfere
- Përfitime sociale
- Shpenzime kapitale
- Shlyerja e borxhit bazë

Buxheti i komunës së Strugës është plan vjetor i konsoliduar i cili përveç buxhetit të komunës përfshin dhe buxhetin e 15 institucioneve komunale, përkatësisht:

1. **SHKF “Orhan Xhemaili” - f. Tatesh i Epërm**
2. **SHFK “Vëllezërit Milladinov ” - Strugë**
3. **SHFK “Nuri Mazari ” – f. Dollogozhdë**
4. **SHFK “Josip Broz Tito” - Strugë**
5. **SHFK “Zini Hani” - f. Veleshtë**
6. **SHFK “Bashkimi” - f. Oktis**
7. **SHFK “Murat Labunishti” - f. Labunisht**
8. **SHFK “Goce Dellçev” - f. Podgorcë**
9. **SHFK “Ashim Agushi” - f. Ladorisht**

10. **SHFK "Goce Dellçev" - f. Jabllanicë**
11. **SHFK "Kliment Ohridski" - f. Drasllajcë**
12. **SHFKM Strugë (shkolla e muzikës) - Strugë**
13. **SHMK "Dr.Ibrahim Temo" - Strugë**
14. **SHMK "Niko Nestor " - Strugë**
15. **EPKÇF "8 Marsi " - Strugë**

Ndërmarrjet publike në vijim janë përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve komunale në komunë:

1. **NP "Komunalja" - Strugë**
2. **NP "Ujësjellës dhe Kanalizime" - Strugë**
3. **NP "Eko Struga" - Strugë**
4. **NP "Komunalja" - f. Labunisht**
5. **NP "Oktisi" - f. Oktis**

BUXHETI QYTETAR është dokument zhvillimor nga komuna, veçanërisht për publikun dhe paraqet buxhetin komunal në format më të thjeshtë dhe më pak teknik për të ndërtuar një kuptim më të mirë për atë se si komuna i menaxhon dhe përdor financat publike. Ky kuptim është me rëndësi kryesore për përgjegjësinë publike dhe për përfshirjen më të madhe të qytetarëve gjatë zbatimit të politikave lokale.



Mekanizmat kyçe të cilat komuna i ndërmerr për përfshirjen e qytetarëve gjatë përgatitjes së buxhetit janë: forume buxhetore, vizitë nëpër vendbanime, mjetet digjitale, takimet me bashkësitë lokale, takimet e rregullta të Kryetarit të komunës me qytetarët, etj.

CILAT JANË KOMPETENCAT E KOMUNËS TONË?

Buxheti i komunës është pasqyrë e politikave/aktiviteteve të komunës sonë dhe të njëjtat dëshmojnë vlerat dhe prioritetet e vetëqeverisjes lokale në të gjitha kompetencat dhe fushat e veprimit.

Planifikimi urbanistik (urban dhe rural)	Mbrojtja e mjedisit dhe natyrës	Zhvillimi ekonomik lokal
Veprimtari komunale	Kulturë	Sport dhe rekreacion
Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve	Arsimi	Kujdesi shëndetësor
Mbrojtje dhe shpëtim	Mbrojtja kundër zjarreve	Kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj

SI I MBLEDH TË HYRAT KOMUNA?

Sigurimi dhe mbledhja efikase e të hyrave komunale është bazë për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve të nevojshme publike për qytetarët tanë. Të hyrat komunale mblidhen përmes buxhetit bazë të komunës, dotacioneve, donacioneve, kredive dhe aktiviteteve vetëfinancuese.

MJETET NË BUXHETIN BAZË VIJNË NGA:


- Të hyrat tatimore (tatimet mbi pronë, taksat komunale dhe kompenzimet e shërbimeve lokale)
- Të hyrat jotatimore (taksat administrative, kompenzime, të ardhurat e tjera jotatimore)
- Të hyrat kapitale (shitja e tokës, koncesione, legalizim i objekteve të ndërtuara pa leje, tarifa për shfrytëzimin e burimeve minerale, kërkime gjeologjike dhe tarifa të tjera)
- Transferta nga nivelet e tjera të qeverisjes (transferta e fondeve nga buxhetet dhe fondet, subvencionimi i TVSH-së, tatimi mbi të ardhurat personale nga pagat e individëve me vendbanim të përhershëm dhe vendqëndrim në komunë)

ÇFARË ËSHTË DOTACIONI? Transfer nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili shërben për financimin e kompetencave të bartura në komunë, si në arsim, mbrojtje sociale dhe fëmijë, kulturë dhe mbrojtje nga zjarri**.**

NGA VIJNË DONACIONET? Donatorë të ndryshëm mund t'i dhurojnë komunës mjete rreptësisht të dedikuara për të ofruar mallra apo shërbime specifike për qytetarët tanë**.**

BUXHETI I KOMUNAVE PËRMBAN EDHE TË HYRA NGA AKTIVITETET VETËFINANCUESE që kryhen nga shfrytëzuesit tanë buxhetor (shkolla, kopshte etj.) në bazë të qirasë nga objektet, kujdesi ditor dhe parashkollor, fonde për ekskursione etj**.**


Të hyrat e përgjithshme të Komunës së Strugës në Buxhetin e vitit 2026 janë vlerësuar në 1,597,984,238 denarë. Në strukturën e të hyrave peshën më të madhe e zë buxheti i dotacioneve, një pjesë të konsiderueshme zë edhe buxheti bazë, pastaj buxheti për aktivitete vetëfinancuese dhe më pas buxheti i donacioneve. (shih grafikun)



Grafiku 1. Struktura e të hyrave komunale sipas burimeve të financimit (në %)

CILAT JANË TË HYRAT KRYESORE NË BUXHETIN E KOMUNËS? Tatime dhe pagesa të tjera të obligueshme ligjore, flukset hyrëse që marrim nga pronësia e mjeteve (kamatat, qiratë, etj.), kompensimet që marrim për mallrat ose shërbimet që ofrojmë, si dhe flukse të tjera hyrëse nga donacionet e tjera, sponsorizimet e tjera, subvencione dhe transfere nga nivelet e tjera të qeverisjes.

Në strukturën e të hyrave kryesore të komunës tonë dominojnë të hyrat e planifikuara nga transfere me 328,337,449 (përfshirë edhe të hyrat e bartura nga viti i kaluar) dhe dotacionet me 879,447,639 denarë, donacionet 12,081,150 denarë të cilat kontribuojnë me 1,219,027,132 denarë, pasojnë të hyrat tatimore me 327,490,000 denarë, më pas të hyrat jotatimore 33,628,000 denarë, të hyra kapitale 17,000,000 denarë (grafiku 2).



Grafiku 2. Struktura e të hyrave komunale sipas sipas klasifikimit ekonomik (në denarë)

BURIMET E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS TONË janë të një rëndësie të veçantë për realizimin e kompetencave lokale dhe ofrimin e shërbimeve komunale. Ato përfshijnë: tatimet lokale, taksat lokale dhe kompenzimet lokale, të hyrat nga pronësia e komunës, vetëkontributet, dënimet me para, donacionet dhe të hyrat e tjera të përcaktuara me ligj. Prandaj, përcaktimi dhe grumbullimi i saktë i tyre është i një rëndësie të madhe, sepse pa këto të hyra, kapaciteti i komunës për të ofruar shërbimet/të mirat e nevojshme për qytetarët e saj do të jetë i kufizuar.

TË HYRAT TATIMORE janë pjesa themelore dhe më e rëndësishme e të hyrave vetanake të komunës. Ato mblidhen nëpërmjet: tatimit në pronë, tarifave komunale (firmarinë, shfrytëzimit të hapësirës pranë objekteve afariste, ndriçimit rrugor etj.), kompensimi për zhvillimin e tokës ndërtimore (komunale), tarifave të shfrytëzimit ose lejeve për kryerjen e një veprimtarie të caktuar dhe të hyra të tjera tatimore.




Grafiku nr.3 Të hyrat tatimore të komunës së Strugës (në denarë)

Në të hyrat tatimore të komunës tonë, peshën më të madhe e zënë taksat për shërbime specifike (zhvillimi i tokës ndërtimore, taksa komunale për ndriçimin publik, firmarinë, etj.) me 220,010,000 denarë, pasuar nga tatimet mbi pronë me 83,200,000 denarë ndërsa një pjesë më të vogël zënë tatimet në të ardhura, fitim dhe fitime kapitale me 24.180.000 denarë, kurse pjesën më të vogël e kanë tarifat për shfrytëzim ose leje për kryerjen e veprimtarisë prej 100.000 denarë.

PSE DUHET TA PAGUAJMË TATIMIN MBI PRONË?

Tatimi në pronë është një nga të hyrat vetanake më të rëndësishme të komunës. Pagesa e tyre në kohë nga qytetarët dhe bizneset është veçanërisht e rëndësishme për krijimin e një komune moderne me cilësi më të mirë të jetës.

Komuna e Strugës ka ndërmarrë aktivitete konkrete për përmirësimin e planifikimit dhe mbledhjes së tatimit në pronë, si përditësimi i vlerës së tregut të pronës, riorganizimi i zonave territoriale, vendosja e pagesës elektronike dhe aktivitete të tjera që synojnë rritjen e mbledhjes së tatimit. Struktura e llojeve specifike të tatimit në pronë që komuna jonë planifikon të mbledhë në vitin 2026 është paraqitur më poshtë.



Grafiku nr.4 Tatime mbi pronë në komunën e Strugës (në denar)

ÇFARË JANË TAKSAT KOMUNALE?

Taksat komunale janë të hyra që paguhen për shfrytëzimin e të drejtave të përcaktuara, lëndë dhe shërbime me karakter publik nga persona juridikë dhe fizikë që kryejnë veprimtari edhe nga qytetarët. Lartësinë e taksës komunale e përcakton komuna në pajtim me ligjin. Komuna planifikon të arkëtojë pjesën më të madhe të parave nga taksa për rregullimin e tokës ndërtimore, nga taksa komunale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe taksa komunale për vendosjen e reklamave të firmës.


Taksa komunale	Shuma	%
Taksa komunale për qëndrim të përkohshëm	5.000.000	2,27%
Taksa komunale për reklamim të firmave	12.000.000	5,45%
Taksa komunale për shfrytëzim të rrugëve që paguhet gjatë regjistrimit të ,veturave	7.000.000	3,18%
Taksë komunale për shfrytëzim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik	70.000.000	31,82%
Kompenizimi për rregullimin e tokës ndërtimore	123.960.000	56,34%
Kompenzimi për veprimtari komunale	**1.000.000**	**0,45%**

Tabela 1. Taksat komunale në komunë janë planifikuar 226,250,000 denarë ose 66,05% të të hyrave tatimore

TË HYRAT JOTATIMORE

Komuna jonë arkëton ose mbledh edhe të hyra jotatimore, tarifa dhe të hyra të tjera që lidhen me shërbime të caktuara që u ofrojmë qytetarëve dhe bizneseve. Të ardhurat jotatimore që ne planifikojmë të mbledhim në vitin 2026 janë paraqitur më poshtë.

Shuma më e madhe e të hyrave jotatimore është planifikuar të arkëtohen nga shfrytëzues të buxhetit në vlerë të përgjithshme prej 33,628,000 denarë, ndërsa më së paku të hyra jotatimore pritet të sigurohen nga të hyrat tjera jotatimore dhe gjobat.




Grafiku 5. Të hyrat jotatimore në komunën e Strugës (në denarë)

TRANSFERE NGA PUSHTETI QËNDROR

Komuna ka edhe burime të tjera financiare, edhe atë një shumë të konsiderueshme nga pushteti qëndror në formën e transfereve nga ministritë përkatëse ose fondet e qeverisë. Këto transfere janë të rëndësishme në buxhetin e komunës dhe janë të rëndësishme për sigurimin e funksionimit normal dhe ushtrimin e kompetencave dhe realizimin e projekteve infrastrukturore.


Shuma më e madhe e transfereve është planifikuar të sigurohet përmes bllok-dotacioneve, në vlerë prej 879,447,639 denarë, transferi nga TVSH-ja është planifikuar të jetë 109,188,897 denarë, transferet nga nivelet e tjera të qeverisjes janë planifikuar në vlerë prej 187,148,552 denarë, transfere nga buxhetet dhe fonde 7,000,000 denarë dhe 25,000,000 denarë janë planifikuar të hyra të mbetura nga viti i kaluar.

.



Grafiku 6. Transfere dhe dotacione në komunë janë planifikuar 1,193,552,761 (në denarë)

Bllok dotacionet për kompetencat e deleguara nga qeveria qendrore, janë thelbësore për financimin e kompetencave tona në fushën e arsimit dhe mbrojtjes sociale. Shpërndarja e këtyre bllok dotacioneve për qëllime të ndryshme është paraqitur më poshtë.



Grafiku 7. Planifikimi i bllok dotacioneve sipas kompetencave të Komunës së Strugës (në denarë)


DONACIONET/GRANTET

Donacionet janë mjete financiare dhe paraqesin të hyra të cilat për vitin 2026 vlerësohen në vlerë prej 10,766,673 denarë dhe 1,314,477 denarë janë të hyra të bartura nga viti i kaluar ose gjithsej donacione në vlerë prej 12,081,150 denarë. Mjetet nga këto donacione janë të dedikuara rreptësisht për realizimin e projekteve. Të hyrat janë siguruar nga Bashkimi Evropian në shumë prej 5,127,567 denarë, nga donacionet tjera dhe të përgjithshme rrjedhëse 5,639,106 denarë.

KU DHE SI SHPENZOHEN PARATË E KOMUNËS?

Është shumë e rëndësishme që qytetarët tanë të kenë njohuri se ku dhe si shpenzohen resurset lokale. Shpenzimet lokale janë të lidhura drejtpërdrejt me ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme që u ofrohen qytetarëve, prandaj është e rëndësishme që struktura dhe mënyra e shpërndarjes së tyre të paraqiten në mënyrë transparente.


Në vitin 2026, komuna planifikon të shpenzojë gjithsej 1,597,984,238 denarë për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për qytetarët. Prej tyre 17,59% janë planifikuar për investime kapitale në vlerë prej 281,091,449 denarë me çka planifikohet të bëhet ndërtimi i infrastrukturës së re, rikonstruimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese si dhe përmirësimi i shërbimeve të përgjithshme publike.



Grafiku 8. Gjithsej shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik të komunës 1,597,984,238 denarë


Tre lloje kryesore të shpenzimeve në buxhetin e vitit 2026 në komunën tonë janë: pagat dhe kompenzimet, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet kapitale.

Pagat dhe kompenzimet paraqesin shumën më të madhe të shpenzimeve nga llogaria e komunës dhe arrijnë vlerën prej 1,078,444,196 denarë ose 67,49% dhe kanë të bëjnë me të punësuarit në komunë dhe institucionet që janë në kompetencë të saj. Prej tyre, pjesa më e madhe, në vlerë prej 619,601,000 denarë, është planifikuar për shkollat fillore, për shkollat e mesme 201,936,106 denarë dhe 41,584,639 denarë për çerdhen e fëmijëve. Shpenzimet e tjera të rrogave do të shpenzohen për administratën komunale, zjarrfikësit dhe kompenzimet e këshilltarëve.



Grafiku 9. Shpenzimet e rrogave dhe kompenzimeve sipas kompetencave të Komunës së Strugës (në denarë)


Shpenzimet e planifikuara për **mallra dhe shërbime** në vlerë prej 158,176,823 denarë e mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të komunës, dhe kanë të bëjnë me shpenzimet për shërbimet komunale, ngrohje, komunikim, transport, inventar të imët, riparime, mirëmbajtje të vazhdueshme, shpenzime të udhëtimit, shërbime kontraktuese, paga për personelin e përkohshëm etj. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve ndahen për arsimin fillor dhe kopshtin e fëmijëve, zjarrfikësit, që financohen nga buxheti bazë i komunës, buxheti i aktiviteteve vetëfinancuese, buxheti i dotacioneve dhe buxheti i donacioneve. Komuna planifikon që pjesën më të madhe të buxhetit të saj ta shpenzoj për mallra dhe shërbime komunale dhe administratën komunale.



Grafiku 10. Shpenzime për mallra dhe shërbime sipas kompetencave të komunës së Strugës (në denar)

Komuna jonë planifikon që në vitin 2025 të fillojë me implementimin e disa projekteve kapitale/infrastrukturore dhe të tjera që duhet të përmirësojnë jetën dhe mirëqenien e qytetarëve**.**

Shpenzimet kapitale të komunës tonë janë vendimtare për cilësinë e jetës së qytetarëve tanë, prandaj në vitin 2026, ata do të marrin pjesë me 17,59% në strukturën e totalit të shpenzimeve buxhetore të konsoliduara. Pjesa më e madhe e tyre janë të destinuara për aktivitete komunale, në vlerë prej 265,411,449 denarë.



Grafikoni 11. Shpenzime kapitale sipas kompetencave të komunës së Strugës (në denarë)

Në buxhetin e Komunës së Strugës për vitin 2026 janë planifikuar 77,671,770 denarë për subvencione dhe transfere ose 4,86% kurse rezerva rrjedhëse 2,100,000 denarë.


SA PLANIFIKON TË SHPENZOJË KOMUNA JONË PËR ÇDO KOMPETENCË/PROGRAM?

Për të paraqitur në mënyrë transparente qëllimin për të cilin komuna planifikon t'i shpenzojë të hyrat në dispozicion, më poshtë janë paraqitur shpenzimet buxhetore kryesore të planifikuara për secilën nga kompetencat (programet) të caktuara për qytetarët tanë.

Shpenzimet që komuna planifikon t'i shpenzojë për **Administratën komunale** janë në vlerën prej 258,089,000 denarë, janë të caktuara për paga dhe kompensime, shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, materiale për inventar të imët, riparime dhe mirëmbajtje aktuale, shërbime kontraktuale, shpenzime të tjera rrjedhëse dhe punësime të përkohshme, dhe transfera në pension dh transfera të tjera.


Komuna planifikon të shpenzojë 12,810,000 denarë për blerjen e mobiljeve për zyrë, pajisje, makineri, softuer kompjuterik dhe kompenzim për pronën e marrë.

Shpenzimet për funksionimin e **Këshillit të Komunës** janë 11,556,000 denarë dhe janë të destinuara për kompenzim të këshilltarëve, shërbime komunale dhe shpenzime tjera rrjedhëse.
Shpenzimet e përgjithshme të caktuara për punën e **Kryetarit** arrijnë në 9,916,000 denarë dhe përfshijnë: pagat dhe shtesat e kryetarit, mallrat dhe shërbimet, rezervën aktuale për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve dhe transfere deri te organizatat joqeveritare, transfere për punonjësit apo shfrytëzuesve buxhetor që pensionohen.



Grafiku 12. Shpenzimet e programeve-Këshilli, Kryetari i komunës dhe Administrata komunale (në denarë)

Për planifikim urbanistik komuna ndan 2,900,000 denarë, të caktuara për përgatitjen e planeve urbanistike dhe shpenzime tjera operative.




Grafiku 13. Shpenzimet e programeve sipas kompetencave për Planifikim urbanistik (në denarë)

Komuna jonë në mënyrë serioze përpiqet të ofrojë një nivel adekuat të shërbimeve komunale, duke u kujdesur për pastërtinë publike, ndriçimin publik, mirëmbajtjen ose ndërtimin rrugëve dhe rrugicave lokale, furnizimin me ujë dhe shumë shërbime të tjera lokale veçanërisht të rëndësishme për cilësinë e jetës së qytetarëve.


Shpenzimet e ndara për **shërbimet komunale** në vlerë prej 257,115,142 denarë kanë për qëllim mbështetjen e aktiviteteve për ndërtimin e investimeve të reja kapitale dhe mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese kapitale si: pajisje urbane, ujësjellës, kullim dhe pastrim të ujërave të zeza, pastërti publike dhe gjelbërim publik, rrugë dhe rrugica lokale dhe sinjalistikë në komunikacion.

Nga shpenzimet e planifikuara për ndërtimin e infrastrukturës së re komunale, komuna do të shpenzojë më së shumti për rrugica, rrugët lokale dhe ndriçimin publik.




Grafiku 14. Shpenzime sipas programeve për ndërtim të infrastrukturës së re komunale (në denarë)

Për mirëmbajtjen e rregullt të objekteve ekzistuese infrastrukturore që shërbejnë për ofrimin e shërbimeve komunale për qytetarët, komuna ndan pjesën më të madhe të mjeteve të saj për energjinë elektrike të konsumuar për ndriçimin e rrugicave dhe rrugët lokale dhe sistemet e ujërave të zeza.



Grafikoni nr. 15. Shpenzime sipas programeve për mirëmbajtje të infrastrukturës ekzistuese komunale (në denarë)


Zhvillimi ekonomik lokal është forca lëvizëse e komunës. Për ta mbështetur atë, komuna ndan një shumë prej 7,430,000 denarë, në kuadër të të cilave dominojnë shpenzimet, nga të cilat 7,000,000 denarë janë për pjesëmarrje në projekte dhe pjesa tjetër për shpenzime operative rrjedhëse.



Grafiku nr 16.Shpenzime sipas programeve për kompetencat e zhvillimit ekonomik lokal (në denarë)


Buxheti **për kulturën** përbën një element të rëndësishëm të zhvillimit kulturor. Në Buxhetin e Komunës së Strugës për pjesën e kulturës planifikohen mjete në shumë prej **2,400,000** denarë. Më saktë, këto mjete janë për projekte, përkrahje të manifestimeve kulturo-artistike të komunës së Strugës, si dhe përkrahja e komunës ndaj shoqatave të qytetarëve në pjesën e kulturës.

Mbështjetja për të rinjtë dhe zhvillimin e sportit është një element i rëndësishëm në buxhetin e komunës për vitin 2026. Për **sport dhe rekreacion** planifikohen mjete në shumë prej **4,000,000** denarë. Mjetet e planifikuara i dedikohen përkrahjes së komunës për klubet sportive dhe shoqatat e qytetarëve që kanë të bëjnë me sportin.




Grafiku nr. 17. Shpenzime për programet për kompetencë: Kulturë, Sport dhe rekreacion (në denarë)

Nga shpenzimet e përgjithshme për **Arsim** që planifikohen të realizohen në komunë në vlerë prej 840,347,150 denarë, komuna nga buxheti i saj ndan 8,815,000 denarë për rrymë elektrike, naftë, merematim dhe mirëmbajtje të objekteve, materiale zyre dhe shpenzime të tjera dhe 215,000 denarë për shkollat e mesme. Një shumë e konsiderueshme e shpenzimeve është planifikuar për arsimin fillor në vlerë 638,411,044 kurse për arsimin e mesëm janë planifikuar 201,936,000 denarë. Buxheti për aktivitete vetëfinancuese për arsimin fillor është 4,368, denarë dhe për arsimin e mesëm është 4,620,000 denarë.



Grafiku nr. 18. Shpenzime sipas programeve për kompetencë- Arsim (denarë)

Shpenzimet e përgjithshme për **çerdhen** janë planifikuar në vlerën prej 57,734,639 denarë, nga të cilat pjesa më e madhe prej 42,584,639 janë bllok-dotacione dhe kanë të bëjnë me pagat dhe shpenzime rrjedhëse ndërsa 15,150,000 denarë janë planifikuar nga aktivitetet vetëfinancuese dhe 1,650,000 denarë janë planifikuar shpenzime kapitale.



Grafiku nr 19. Shpenzime sipas programeve për kompetencë të Mbrojtjes sociale dhe mbrojtje të fëmijëve (në denarë)

Komuna jonë kujdeset për mjedisin jetësor dhe mjedisin e shëndetshëm jetësor të qytetarëve të saj, duke ndarë shumën e duhur prej 2,360,000 denarë për dezinfektim, deratizim, shërbime për mbrojtjen e ujit, lumenjve dhe liqeneve dhe shpenzime tjera operative.

Për nevojat e **njësisë së zjarrfikësve** të komunës së Strugës janë planifikuar 20,225,000 denarë, pjesa më e madhe e kësaj shume është për pagat dhe kompenzime të zjarrfikësve në shumë prej 17,000,000 denarë, të cilat komuna i merr nga dotacione të dedikuara nga Ministria e mbrojtjes. Pjesa e mbetur për mallra, shërbime dhe blerje pajisjesh në vlerë prej 3,225,000 do të financohet nga buxheti i komunës.

Komuna jonë i kushton vëmendje serioze aspektit të **barazisë gjinore** në planifikimin e të gjitha aktiviteteve të saj. Si rrjedhojë, ne ndajmë edhe një shumë të përshtatshme të mjeteve komunale për përkrahjen e barazisë gjinore në shumë prej 700,000 denarë.

Kompetenca	Износ
Mbrojtja e natyrës dhe ambjentit jetësor	**2.360.000**
Avancimin e mbrojtjes shëndetësore	**0**
Mbrojtja kundër zjarreve	**20.225.000**
Shpenzime kapitale për mbrotjen kundër zjarreve	**0**
Barazi gjinore	**700.000**
Programe për zhvillim	**9.615.000**
Mbrojtje dhe shpëtim	**200.000**

DOKUMENTET KRYESORE BUXHETORE - si mundet qytetarët ta përcjellin realizimin e buxhetit komunal?

- **Kalendari buxhetor** përcakton afatet për planifikimin e buxhetit komunal, i cili përfshin të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me përgatitjen e buxhetit.

- **Drafti buxhetor** përmban udhëzimet kryesore për përgatitjen e buxhetit komunal dhe dorëzohet nga Ministria e Financave.

- **Propozim buxheti** përgatitet nga ana e kryetarit (administrata komunale) në të cilin planifikohen të hyrat dhe shpenzimet vjetore dhe duhet të miratohet nga ana e Këshillit të komunës.

- **Propozimin e planit të programeve për zhvillim** i cili përmban projeksionet afatmesme të fondeve të miratuara për programet dhe nënprogramet buxhetore individuale, vitet në të cilat do të zbatohen dhe burimet e financimit, pra buxhetet.

- **Buxheti** është një akt i pushtetit lokal që planifikon të ardhurat vjetore dhe të hyrat e tjera dhe miraton shpenzimet vjetore dhe të dalat e tjera të shtetit ose komunës.

- **Raportet mujore** i paraqesin të dhënat për totalin e të hyrave dhe shpenzimeve operative dhe kapitale për muajin paraardhës të cilit i referohet periudha raportuese.

- **Raporti kuartali K1** përmban të dhëna për totalin e të hyrave dhe shpenzimeve operative dhe kapitale për tre muajt e mëparshëm të cilëve u referohet periudha raportuese, në përputhje me klasifikimin ekonmik të të hyrave dhe shpenzimeve sipas llogarisë dhe në total.

- **Raporti kuartali K2** përmban të gjitha të dhënat për të gjitha detyrimet e papaguara, si dhe për detyrimet e papaguara sipas llojit dhe zërave buxhetor**,** me statusin e ditës së fundit të tremujorit paraardhës**.**

- **Raporti kuartali K3** përmban të dhëna për huamarrjen dhe informacione për ndryshimet në bilanc të çdo huamarrjeje në tremujorin paraprak, si dhe ndryshimet në bilanc të garancive të lëshuara dhe të dhëna për borxhin e ndërmarrjeve publike të themeluara nga komunat.

- **Raporti gjashtëmujor** përmban të dhëna për totalin e të hyrave dhe shpenzimeve operative dhe kapitale për gjashtë muajt e mëparshëm të cilit i referohet periudha raportuese.

- **Raporti vjetor** përmban të dhëna për totalin e të hyrave dhe shpenzimeve operative dhe kapitale për një vit për të cilin është periudha raportuese.

Planifikimi i shpenzimeve të komunës së STRUGËS për vitin 2026 (sipas kompetencave dhe klasifikimit ekonomik)

/	Rroga dhe kompenzime	Rezerva	Mallra dhe shërbime	Pagesa të kamatave	Subvencione dhe transfere	Trasnfere sociale	Shpenzime kapitale	Shlyerja e borxhit kryesor	Gjithsej shpenzime
Këshilli i komunës	8.721.000	1.500.000	1.335.000	-	-	-	-	-	**11.556.000**
Kryetari i komunës	2.376.000	600.000	240.000	-	6.700.000	-	-	-	**9.916.000**
Administrata komunale	211.514.000	-	34.275.000	-	12.300.000	-	12.810.000	-	**270.899.000**
Planifikimi urban	-	-	2.600.000	-	300.000	-	-	-	**2.900.000**
Zhvillim ekonomik lokal	-	-	2.930.000	-	8.200.000	-	-	-	**11.130.000**
Veprimtari komunale	-	-	49.600.000	-	36.000.000	-	265.411.449	-	**351.011.449**
Kulturë	-	-	1.400.000	-	1.000.000	-	-	-	**2.400.000**
Sport dhe rekreacion	-	-	-	-	4.000.000	-	-	-	**4.000.000**
Programi për zhvillim	-	-	2.965.000	-	6.500.000	-	150.000	-	**9.615.000**
Arsimi	797.248.557	-	40.696.823	-	2.171.770	-	1.070.000	-	**841.187.150**
Mbrojtja e natyrës dhe ambjentit jetësor	-	-	2.360.000	-	-	-	-	-	**2.360.000**
Avancimi i mbrotjes shëndetësore	-	-	-	-	-	-	-	-	**-**
Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve	41.584.639	-	15.950.000	-	200.000	500.000	1.650.000	-	**59.884.639**
Mbrojtja kundër zjarreve	17.000.000	-	3.225.000	-	-	-	-	-	**20.225.000**
Mbrojtje dhe shpëtim	-	-	200.000	-	-	-	-	-	**200.000**
Barazi gjinore	-	-	400.000	-	300.000	-	-	-	**700.000**
Gjithsej	1.078.444.196	2.100.000	158.176.823	-	77.671.770	500.000	281.091.449	-	**1.597.984.238**

KOMUNA E STRUGËS

Kryetar,

Mendi Qyra

Përgatiti:

Sektori për çështje financiare

Njësia për koordinim buxheti

Udhëheqës i njësisë

Mr. Gëzim Elmazi